



## **VENDIM PËR HEQJEN E ANKESËS NGA LISTA**

**Data e miratimit: 13 qershor 2017**

**Numri i lëndës: 2015-14**

**Miodrag Konić**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 13 qershor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Noora AARNIO, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, vendosi si në vijim:

### **I. PROCEDURA PARA PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar me 23 dhjetor 2015.
2. Me 22 mars 2017, Sekretariati i Panelit i ka dërguar një letër z. Miodrag Konić-i, duke i kërkuar atij që të japë informacione të mëtejshme lidhur me përfshirjen e EULEX-it. Pasi që z. Konić-i nuk e

kishte ofruar në ankesë një adresë të hollësishme, por vetëm emrin e fshatit të tij, një anëtar i Sekretariatit kishte shkuar në fshatin e përmendur dhe ishte përpjekur ta gjente atë. Pas një përpjekjeje të dështuar për ta bërë këtë gjë, letra ishte lënë tek “administratori i fshatit”, i cili kishte premtuar ta dorëzonte atë. Sekretariati gjithashtu ishte përpjekur të kontaktojë z. Konić me telefon, mirëpo po ashtu pa sukses.

## **II. FAKTET**

3. Ankuesi deklaron se ai dhe gruaja e tij ishin sulmuar tre herë gjatë vitit 2014; se shtëpia e tyre ishte thyer dhe se ata ishin sulmuar fizikisht. Ai i ka raportuar të gjitha sulmet në Policinë e Kosovës. Policia me sa duket ka zhvilluar një hetim.
4. Ankuesi më tej deklaron se si dhe gruaja e tij ishin sulmuar prapë me 18 maj 2015. Prapë Policia kishte zhvilluar një hetim. Këtë herë Policia i kishte arrestuar kryesit e veprës.

## **III. ANKESAT**

5. Ankuesi pohon se e drejta e tij dhe e gruas së tij për jetë dhe liri të lëvizjes, liri të mendimit dhe liri të shprehjes janë shkelur. Ai kërkon nga Paneli që t'i gjejnë kryesit e veprës, t'i dënojnë ata dhe duke vepruar kështu ta çlirojnë ankuesin nga stresi i frikës për sigurinë e tyre.

## **IV. LIGJI**

6. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
7. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Sipas rregullit 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të

njeriut të kryera nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana.

9. Sipas rregullit 29 e *tutje*, paragrafi 1 i rregullores së vet të punës, Paneli mundet që në çdo fazë të procedurës të vendosë që ta heq ndonjë ankesë nga lista e lëndëve, atëherë kur rrethanat çojnë në përfundim se ankuesi nuk ka qëllim ta vazhdoj ankesën e tij/saj.
10. Ankuesi në formularin e aplikimit nuk i ka ofruar Panelit ndonjë adresë në të cilën mund të kontaktohej ose ndonjë numër telefoni në të cilin mund të telefonohej. Si rezultat, Paneli nuk ishte në gjendje të merrte nga ankuesi informacionin e nevojshëm për përmbushjen e mandatit të tij dhe kështu nuk ishte në gjendje të konstatojë interesimin e vazhduar të ankuesit për ta vazhduar çështjes (*Hajdari kundër EULEX-it*, lënda nr. 2014-40, paragrafi 14; *Shefki Hyseni kundër EULEX-it*, lënda nr. 2014-21, par. 11). Prandaj dhe në mungesë të treguesit *prima facie* të shkeljes së të drejtave të njeriut që i ngarkohen EULEX-it (shih rregullën 29 e *tutje*, paragrafi 2 i rregullores së punës) Paneli ka konstatuar se nuk do të jetë e arsyeshme në këto rrethana të vazhdohet shqyrtimi i kësaj ankese.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

11. Paneli njëzëri vendos të heq këtë ankesë nga lista e lëndëve, në pajtim me rregullën 29 e *tutje*, paragrafin 1 (1) të rregullores së punës.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese